



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN	
DATA / DTT	30.01.2020
NR. LQ. / BR. ST.	
DATUM / DATUM	15.03.2020
VUŠTHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
K r y e t a r i

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, si dhe me propozim të shtabit komunal për mbrojtje nga COVID-19 pas një diskutimi nga mbledhja e mbajtur më 15.03.2020, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

Deklaratë Publike

1. Ftojmë të ardhurit në komunën e Vushtrrisë, nga Italia, Gjermania dhe shtetet tjera me përfshirje të lartë nga koronavirusi që të vet izolohen për të iu shmangur rrezikut të përhapjes së kësaj sëmundje.
2. Secili qytetar i komunës së Vushtrrisë i cili dyshon se mund të jetë i infektuar me koronavirus, të lajmërohen në nr. tel. 038/20080800.
3. Edhe përkundër faktit se në Komunën e Vushtrrisë nuk ka asnjë rast të infektimit me koronavirus, të përcillet me vëmendje të shtuar situata e përgjithshme rreth përhapjes së kësaj sëmundje dhe të sillemi me përgjegjësi të plotë në mënyrë që të tejkalohet me sa më pak kjo gjendje në të cilën ndodhemi.
4. Përgëzojmë stafin shëndetësorë të Komunës së Vushtrrisë në për angazhimin e pakursyer në ndërmarrjen e masave preventive dhe për gatishmërinë e tyre për punë të pandërprerë për ruajtje të shëndetit dhe jetës së qytetarëve.
5. Si komunë do të përcjellim me vëmendje të shtuar gjendjen në terren dhe do të ndërmerr masa adekuate në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë ligjore në fuqi në Republikën e Kosovës.

Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

